



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

25.04.2016

02-013/502



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe Kontratës për bashkëfinancim të bizneseve fillestare dhe ekzistuese në Komunën e Vitisë të datës 17.04.2015 e lidhur në mes të Komunës së Vitisë dhe Fondacionit Kosovo – Luxembourg, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

V E N D I M

PËR TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 34.060,00 € NË EMËR TË
BASHKËFINANCIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

I

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë LEJON transferimin e mjeteve financiare në shumë prej 34.060,00€ (me fjalë tridhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë euro) Fondacionit Kosovo – Luxembourg për realizimin e projektit- investim i përbashkët: Bashkëfinancim të bizneseve fillestare dhe ekzistuese në Komunën e Vitisë bazuar në Kontratën për bashkëfinancim të bizneseve fillestare dhe ekzistuese në Komunën e Vitisë të datës 17.04.2015 e lidhur në mes të Komunës së Vitisë dhe Fondacionit Kosovo – Luxembourg.

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti, Participim i projekteve me donator, kodi i projektit 90552.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në xhirollogari të Fondacionit Kosovo-Luxembourg.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

02. Nr. 013/
Viti, më 21.04.2016

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

